

# **NJOFTIMI I MODIFIKIMIT TË** **KONTRATËS GJATË KOHËZGJATJES SË** **SAJ**

## **BASHKIA DIVJAKË**

NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR/KONTRATËS GJATË  
ZBATIMIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Emri Bashkia Divjakë  
Adresa Lagjia nr.2  
Tel/Faks 0371 22081  
E-mail info@bashkiadivjake.gov.al  
Ueb-faqe www.bashkiadivjake.gov.al

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri Vojsava Leçini (Caktuar me Urdhërin Nr. 176 datë 22.04.2026 me Nr. 3579 Prot.)  
E-mail vojsavalecini@bashkiadivjake.gov.al

3. Lloji i procedurës së prokurimit: “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”

4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes Kuadër: Mallra.

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: REF-51326-06-16-2025

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Blerje binderi (furnizim/vendosje) për shtrimin e rrugëve urbane të Bashkisë Divjakë për vitin 2025”

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): (CPV): 44113100-6 Materiale asfaltimi, (CPV): 14213100-8 Asfalt bitumi.

8. Fondi limit: 66 658 110 (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e njëqind e dhjetë) lekë pa Tvsh, nga e cila: 3 333 333 (tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa Tvsh nga të Ardhurat e Bashkisë Divjakë dhe 63 324 777 (gjashtëdhjetë e tre milion e treqind e njëzetë e katër mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa Tvsh nga Granti.

Për vitin 2025: 13 110 610 (trembëdhjetë milion e njëqind e dhjetë mijë e gjashtëqind e dhjetë) lekë pa Tvsh, nga e cila:

3 333 333 (tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa Tvsh nga të Ardhurat e Bashkisë Divjakë

6 452 500 (gjashtë milion e katërqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë pa Tvsh nga Granti

3 324 777 (tre milion e treqind e njëzetë e katër mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa Tvsh nga Granti

Për vitin 2026: 25 000 000 (njëzetë e pesë milion) lekë pa Tvsh nga Granti

Për vitin 2027: 28 547 500 (njëzetë e tetë milion e pesëqind e dyzetë e shtatë mijë e pesëqind) lekë pa Tvsh nga Granti

Vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është 680 254 (gjashtëqind e tetëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër) euro pa TVSH

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për monedhën euro në datë 16.06.2025 është 97.99

Burimi i financimit: Granti + Të ardhurat e Bashkisë Divjakë.

9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë: Ky amendament kontrate, lidhet bazuar në Nenin 127 pika 1 shkronja “c” të Ligjit Nr.162 datë 23/12/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në Nenin 107 të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në zbatim të Nenit 8, 9, 25, 26, 27 të kontratës me Nr. 11194 Prot, datë 27.10.2025, në shkresën me Nr. 12 Prot., datë 20.04.2026, “Kërkesë për shtyrje afati të punimeve për objektin Blerje binderi (furnizim/vendosje) për shtrimin e rrugëve urbane të Bashkisë Divjakë për vitin 2025” protokolluar pranë institucionit tonë me Nr. 3509 Prot., datë 20.04.2026, si edhe në relacionin teknik me Nr. 3509/1 Prot., datë 22.04.2026, të paraqitur nga ana e grupit të punës për ecurinë e zbatimit të kontratës dhe marrjen në dorëzim të mallit.

Shkak i kërkesës për shtyerjen e afatit të kontratës, është;

Sipas njoftimit zyrtar të operatorit ekonomik “BIBA-X” SHPK, vonesat në kryerjen e punimeve kanë ardhur për shkak të kushteve atmosferike të pafavorshme, të karakterizuara nga reshje të vazhdueshme dhe lagështi e lartë, të cilat kanë pamundësuar zhvillimin normal të procesit të shtrimit të binderit. Ky proces kërkon domosdoshmërisht sipërfaqe të thatë dhe kushte të përshtatshme temperaturash, në të kundërt çënohen parametrat teknike dhe cilësia e punimeve.

Ndikimi i këtyre kushteve nuk lidhet vetëm me ditët konkrete të ndërprerjes së punimeve, por dhe me kohën e nevojshme për tharjen dhe stabilizimin e shtresave ekzistuese, si dhe për rifillimin dhe riorganizimin e procesit të punës në përputhje me standardet teknike.

Gjithashtu, kjo periudhë është ndikuar edhe nga ditët e pushimeve zyrtare të cilat kanë kufizuar vijimin e pandërprerë të punimeve dhe organizimin operacional në kantier, duke kontribuar në zgjatjen e afatit të nevojshëm për realizimin korrekt të kontratës.

Theksojmë se këto rrethana janë plotësisht jashtë kontrollit të operatorit ekonomik dhe nuk lidhen me neglizhencë apo mungesë angazhimi nga ana jonë. Përkundrazi, çdo tentativë për vijimin e punimeve në kushte të papërshtatshme do të sillte rrezik për cilësinë dhe jetëgjatësinë e investimit, duke rënë ndesh me detyrimet kontraktuale dhe interesin publik.

Komisioni për ndjekjen e ecurisë së zbatimit të kontratës dhe marrjen në dorëzim të mallit, në zbatim të kontratës me objekt: “Blerje binderi (furnizim/vendosje) për shtrimin e rrugëve urbane të Bashkisë Divjakë për vitin 2025”, propozoi aprovimin e kërkesës për shtyrje të afatit të kontratës për një periudhë 30 (tridhjetë) ditë, konkretisht deri më datë 27.05.2026.

10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e mallrave:

Modifikimi i kësaj kontrate është bërë me qëllim shtyrjen e afatit të dorëzimit të mallrave, dhe nuk sjell asnjë ndryshim në natyrën, sasinë dhe vlerën e mallrave të cilat mbeten të pandryshuara. Kushtet e kontratës bazë të nënshkruar me Nr. 11194 Prot, datë 27.10.2025, janë të vlefshme edhe për këtë amendament kontrate.

11. Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër: 60 731 304 (gjashtëdhjetë milion e shtatëqind e tridhjetë e një mijë e treqind e katër) Lekë me Tvsh nga e cila: 11 731 732 (njëmbëdhjetë milion e shtatëqind e tridhjetë e një mijë e shtatëqind e tridhjetë e dy) Lekë me Tvsh nga Granti Për vitin 2025: 7 743 000 (shtatë milion e shtatëqind dyzet e tre mijë) Lekë me Tvsh nga Granti kodi 231,

Për vitin 2025: 3 989 732 (tre milion e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e tridhjetë e dy) Lekë me Tvsh nga Granti, kodi 602

Për vitin 2026: 25 000 000 (njëzet e pesë milion) Lekë me Tvsh nga Granti, kodi 231

Për vitin 2027: 23 998 572 (njëzet e tre milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e dy) Lekë me tvsh nga Granti, kodi 231

12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti): Vlera e modifikimit të kontratës është 0 (zero) lekë.

13. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër: Kontrata bazë e nënshkruar me Nr. 11194 Prot, datë 27.10.2025 është me afat 6 (gjashtë) muaj nga momenti i nënshkrimit të saj.

Me Amendamentin Nr. 1 të nënshkruar më datë 27.04.2026 afati i kontratës është shtyrë me 30 (tridhjetë) ditë, duke e çuar afatin e përfundimit të kontratës në datën 27.05.2026. Si rrjedhojë afati total i kontratës pas Amendamentit Nr. 1 është 7 (shtatë) muaj.

Dhe afati i ri (nëse është rasti): Afati i përfundimit të kontratës, shtyhet deri në datën 27.05.2026. Amendamenti për shtyrjen e afatit të kontratës është nënshkruar më datë 27.04.2026.

14. Emri dhe adresa e Operatorit/ëve Ekonomikë:

Emri: "BIBA-X" Shpk

NIPT: K32618815N

Adresa: Tiranë, Lekaj HARIZAJ Fshati Kryeluzaj, Pika Inerte 50m pranë Karburant "EURODRIN"

Kontaktet: Telefoni: 0682093525; E-mail: infobibax@yahoo.com

15. Data e nënshkrimit të modifikimit: Amendamenti për shtyrjen e afatit të kontratës është nënshkruar më datë 27.04.2026.

16. Burimi i financimit: Granti + Të ardhurat e Bashkisë Divjakë.

17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti/enti kontraktor \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_